



Kimete Fazliu nga Prishtina me profesion juriste e diplomuar ka një përvojë të gjatë mbi tri dekada në fushën juridike dhe menaxheriale në sektorin publik. Ka diplomë universitare në drejtësi dhe në studimet postdiplomike me titull Master i të drejtës kushtetuese dhe administrative në Universitetin e Prishtinës-Fakultetin juridik, si dhe ka të përfunduar edhe provimin e jurisprudencës. Ajo poashtu ka ndjekur trajnime të shumta për zhvillim në fushën e menaxhimit dhe lidërshipt si dhe e ka të kryer provimin për auditor të brendshëm të QMS (Sistemi i Menaxhimit të cilësisë) me standardin ISO 9001:2008, por edhe shumë trajnime tjera nga fusha e legjislacionit dhe zhvillimit

strategjik të Burimeve Njerëzore, për të cilat posedon certifikata. Përvoja e saj e punës është fillimisht në Korporatën energjetike të Kosovës si juriste, e mëpas si profesoreshë e lëndëve profesionale juridike në shkollën e mesme ekonomike juridike në Prishtinë. Nga data 01 korrik 2006 punon në NPQ KOSTT - Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh. a. si Menaxhere e Sektorit të Personelit ku gjendet edhe aktualisht, derisa në periudhën e themelimit të KOSTT-it (pas ndarjes nga KEK-u), nga viti 2006 deri në fund të vitit 2008 ka ushtruar edhe detyrën e Sekretarit të Bordit të Drejtorëve të KOSTT. Në procesin e themelimit të KOSTT, ajo ka dhënë një kontribut të madh, përveç tjerash ajo që vlen të potencohet është angazhimi në procesin e hartimit të të gjitha akteve të brendshme normative (rregulloreve dhe politikave të reja) nga fusha e punës për punonjësit, por edhe në krijimin e sistemeve të punës duke bërë ndryshime në hap me trendet e reja. Nga data 10 janar 2024 ushtron edhe detyrën e Drejtorit të Bordit në NPQ Hekurudhat e Kosovës - Trainkos sh.a. si dhe është anëtare në Komisionin e Auditimit.

Email: kimete.fazliu@trainkos.com

Tel. 038/534-821